


SL 3D EPOXY



PERSHKRIMI

Vetënivelues me dy përbërës, me bazë epokside.

KARAKTERISTIKAT

SL 3D EPOXY është një produkt nivelizues me bazë çimento dhe rezinash epokside, si dhe nuk përmban solvent. Ofron avantazhet e mëposhtme:

- Rezistencë mekanike e shkëlqyer.
- Ngjytje shumë e mirë me sipërfaqen ku aplikohet.
- Rezistencë e lartë ndaj lagështirës.
- Cilësi të shkëlqyera vetëniveluese.
- Nuk ka efekt korroziv.

Klasifikohet si SR - B 2,0 - AR 0,5 sipas standardit EN 13813.

FUSHAT E APLIKIMIT

SL 3D EPOXY përdoret për riparime dhe nivelim të sipërfaqeve që do të përdoren për: veshje poliuretani, dysheme PVC, dysheme druri laminat, etj. SL 3D EPOXY aplikohet kur betoni është relativisht i freskët, për të krijuar një sipërfaqe të përshtatshme (të paktën me trashësi 2mm) për aplikimin e shtresave epokside, duke shmangur kështu problemet me shkëputjen, etj. Gjithashtu, është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare, me një trashësi prej 3mm, për sipërfaqe të lëmuara dhe për të rritur rezistencën e sipërfaqes ndaj ngarkesave mekanike.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Komponenti A Paste Komponenti B Leng
Ngjyra:	Sipas katalogut RAL
Raporti pezierjes:	2A : 1B
Densiteti Komp A:	1.05 ± 0.10 Kg/l
Densiteti Komp B:	1.05 ± 0.10 Kg/l
Koha e punueshmerise:	Afersisht 1 ore
Forca ngjitesë (EN 13892-8):	4.2 N/mm ²
Rezistenca ne ngjeshje (EN 13892-2):	
• Pas 4 oresh:	23 N/mm ²
• Pas 24 oresh:	48 N/mm ²
• Pas 7 ditësh:	81 N/mm ²
• Pas 28 ditësh:	150 N/mm ²
Rezistenca ne perkulje (EN 13892-2):	
• Pas 4 oresh:	
• Pas 24 oresh:	24 N/mm ²
• Pas 7 ditësh:	41 N/mm ²
• Pas 28 ditësh:	68 N/mm ²
Rezistenca ndaj gerryerjes:	89 N/mm ²
• Pas 28 ditësh:	≤ 35 µg
Tkurrja (EN 13872):	
• Pas 28 ditësh:	max 0.25 mm/m

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqja ku do të aplikohet produkti duhet të jetë:

- E qëndrueshme dhe e thatë, ose lehtësisht e lagësht.
- E pastër, pa materiale që pengojnë ngjitjen, si pluhur, grimca të lira, yndyrna, etj.

Në sipërfaqe shumë poroze ose thithëse, trajtojeni me një primer epoksidik me bazë uji, siç është ose i holluar me ujë. Primeri aplikohet me furçë ose rul në një shtresë të vetme.

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përbërësit A dhe B janë të pakeluar në proporcione të caktuara për përzierje. Së pari, përbërësi A duhet të përzieret shumë mirë në enën e tij dhe më pas duhet të transferohet në një enë të pastër me vëllim rreth 30 litra. Më pas, duhet të shtohet e gjithë sasia e përbërësit B në përbërësin A. Përzierja e të dyja përbërësve duhet të vazhdojë për rreth 30 sekonda, me një mikser me shpejtësi të ulët (300 rpm). Është e rëndësishme të përzieren mirë pranë anëve dhe fundin e kovatës, për të arritur shpërndarje të barabartë të ngurtësuesit.

APLIKIMI

SL 3D EPOXY duhet të aplikohet me një trashësi deri në 3 mm duke përdorur një screed me dhëmbë. Për të hequr ajrin brenda shtresës vetëniveluese, kaloni një rul të veçantë me dhëmbë mbi sipërfaqe. Kjo parandalon formimin e fluskave dhe ndihmon në arritjen e një trashësie të njëtrajtshme.

PASTRIMI I MJETEVE

Mjetet duhet të pastrohen menjëherë me ujë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

RUAJTJA

24 muaj nëse ruhet në paketim origjinal dhe të pahapur i pa ekspozuar ndaj rrezeve të diellit dhe ngricës.

PAKETIMI

5 Kg / 10 Kg (A+B) Kuti plastike

KONSUMIMI

200 - 300 g/m².

INFORMACION MBI SHËNDETIN DHE SIGURINË

Mbajeni larg fëmijëve. Në rast kontakti me sytë ose gjellitjeje, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni përmbajtjen e enës. Mos e hidhni produktin në kanalizime.

